

# Hyrje

Sipas shkencëtarëve, përpara publikut të zakonshëm javë për javë thuhet “evolucioni është fakt”. Dëshmia, argumentojnë ata, se njeriu evoluoi nga lënda jo e gjallë, përgjatë shumë qindra miliona viteve, është kaq detyruese saqë asnjë shkencëtar i arsyeshëm nuk e vë në dyshim atë. I tillë është opinioni, për shembull, i Dagllas Futuima [Douglas Futuyma], që është Profesor i Ekologjisë dhe Evolucionit në Universitetin Shtetëror të Nju Jorkut. Në librin e tij *Biologji Evolucionare*, ai deklaroi se evolucioni “është një fakt, po aq i plotë sa edhe fakti i rrotullimit të tokës përreth diellit”.<sup>1</sup> Sipas Akademisë Kombëtare të Shkencave në SHBA, “konsensusi shkencor lidhur me evolucionin është i jashtëzakonshëm”.<sup>2</sup> Padyshim, kjo deklaratë do të mbështetej nga Dr. Riçard Paik, [Richard Pike] Drejtuesi Kryesor i Shoqërisë Mbretërore të Kimisë, i cili në prill 2006 kërkoi që fëmijëve t’u mësohej teoria e evolucionit e Darvinit si fakt.<sup>3</sup> Në të njëjtin muaj, Akademia Kombëtare e Shkencave në Mbretërinë e Bashkuar bëri një deklaratë mbi evolucionin, krijimin dhe projektimin inteligjent”.<sup>4</sup> Në të, ata shpallën,

Një nga përparimet më të rëndësishme në njohurinë tonë ka qenë zhvillimi i teorisë së evolucionit me anë të përzgjedhjes natyrore. Që kur është propozuar nga Çarlz Darvini, afro 150 vjet më përpara, teoria e evolucionit është mbështetur nga një sasi në rritje e dëshmive shkencore. Sot ajo është pranuar si shpjegimi më i mirë për zhvillimin e jetës në Tokë që nga fillimet e saj dhe për shumëllojshmërinë e specieve. Evolucionin mësohet me të drejtë si një pjesë thelbësore e biologjisë dhe e lëndëve shkencore në shkolla, kolegje dhe universitete kudo anembanë nëpër botë.

Procesi i evolucionit mund të shihet në veprim sot, për shembull në zhvillimin e rezistencës ndaj antibiotikëve të bakteret që shkaktojnë sëmundje; në rezistencën ndaj pesticideve prej insekteve të dëmshme, dhe në evolucionin e shpejtë të viruseve që janë përgjegjës për gripin dhe SIDAn. Teoria e evolucionit e Darvinit na ndihmon që t’i kuptojmë këto probleme dhe që të gjejmë zgjidhje për to.

Duke ardhur nga disa prej shkencëtarëve kryesorë në botë, thënie të tilla i bëjnë shumë veta që të kuptojnë se teoria e evolucionit është me të vërtetë e pro-

vuar nga ana shkencore, dhe se të besosh ndryshe thjesht është njëloj si ta fusësh kokën në rërë si struci\* [\* Shënim i përkthyesit: Të mos pranosh të përballësh me një problem]. Prandaj, “fondamentalistët Kristianë”, që mbështeten te përmbledhja e krijimit në Bibël, presupozohet se e lenë pas dore shkencën ose se janë “pseudo – shkencëtarë” që nuk e kuptojnë në të vërtetë shkencën. Po a është kjo e vërtetë? A janë në të vërtetë kaq të forta argumentat që prezantohen në mbështetje të evolucionit? Në kapitujt që vijojnë, unë do të demostroj se në fakt ka shumë probleme serioze me teorinë e evolucionit, të cilat rrallë iu prezantohen studentëve apo publikut të gjerë. Për më tepër, unë do të argumentoj se ne mund ta pranojmë në mënyrë të arsyeshme shpjegimin që jep Bibla për jetën dhe të jemi të vërtetë ndaj shkencës.

### Shënime

- 1 **Douglas J. Futuyma**, *Evolutionary Biology* (2nd edn.; Sunderland, MA: Sinauer Associates, 1986), fq. 15.
- 2 National Academy of Sciences, *Teaching about Evolution and the Nature of Science* (Washington DC: National Academy Press, 1998), fq. 56.
- 3 **Jonathan Petre**, ‘Creationism Gathers Strength at Conference’, *Daily Telegraph*, 22 April 2006, te [www.telegraph.co.uk](http://www.telegraph.co.uk)
- 4 April 2006 te: [www.royalsociety.org/news.asp?year=&id=4298](http://www.royalsociety.org/news.asp?year=&id=4298)